



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2671 , datë 3.03.2016

Për

“Miratimin për dokumentit “Rregullore për llogaritjen e kostove neto të Shërbimit Universal Postar””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Sara Reci, në mbledhjen e datës 3.03.2016, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e dokumentit “Rregullore për llogaritjen e kostove neto të Shërbimit Universal Postar”

Dokumentacioni i Grupit të Punës përbëhet nga:

- Projekt vendimi;
- Relacioni Shoqërues i projekt vendimit;
- Dokumenti: “Rregullore për llogaritjen e kostove neto të Shërbimit Universal Postar”.

BAZA LIGJORE:

1. Pika 1 e Nenit 16, të Ligjit Nr.46, datë 7.5.2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 46/2015*);

2. Pika 3 e nenit 114 të Ligjit Nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 9918*);
3. Rregullore e brendshme e AKEP, miratuar me Vendim nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N:

1. AKEP me Vendimin nr. Nr.2649, datë 3.12.2015 miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Rregullore për llogaritjen e kostove neto të Shërbimit Universal Postar*”- *Këshillim Publik*. Dokumenti u publikua në faqen e Internetit të AKEP dhe këshillimi publik u krye në periudhën 3.12.2015-15.02.2016. Gjatë procesit të këshillimit publik si dhe në përfundim të afatit të këshillimit publik në AKEP nuk janë depozituar komente nga palët e interesuara.
2. Grupi i Punës së AKEP i ngritur me Urdhërin nr. 1482, date 23.06.2015, pas përfundimit të afatit të këshillimit pulik ka përgatitur dokumentin “Rregullore për llogaritjen e kostove neto të Shërbimit Universal Postar”. Ky dokument përfundimtar ndryshon nga versioni i nxjerrë në këshillim publik vetem ne seksionin 6: *Fondi i Kompensimit te Shërbimit Universal*. AKEP ka bërë disa ndryshime në këtë seksion, për shkak se nenet 16 dhe 17 të Ligjit 46/2015 parashikojnë që kompensimi i kostove neto të SHU kryhet, vetëm pas miratimit nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, si dhe që rregullat për krijimin dhe administrimin e fondit për shërbimin universal postar në rastin e kompensimit me bashkëfinancim (kontribut i operatorëve) përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Ligji Nr. 46/2015, 2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më datë 7.05.2015. Ky ligj zëvendëson Ligjin nr. 8530, datë 23.9.1999, “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Pika 2 e nenit 65, e ligjit 46/2015 citon: “*Ngarkohet AKEP-i që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 12, pika 1; 14, pika 4; 16, pika 1; 19, pikat 2 dhe 8 ; 31, pika 5; 33, pika 1; dhe 55, pika 6, të këtij ligji*”.
4. Në bazë të nenit 31 të Ligjit 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, ofruesit e shërbimit universal postar duhet të mbajnë llogari të ndara, brenda sistemit të tyre të kontabilitetit, për të dalluar, në mënyrë të qartë, shërbimet dhe produktet që janë pjesë e shërbimit universal postar dhe ato që nuk janë pjesë e këtij shërbimi, me qëllim *llogaritjen e kostove neto të shërbimit universal postar*. Në bazë të nenit 15 të Ligjit 46/2015 kur ofrimi i shërbimit universal postar shkakton kosto neto shtesë, që mund të përbëjnë një ngarkesë të padrejtë për ofruesin e shërbimit universal postar, atëherë ofruesi i shërbimit universal postar ka të drejtë të kërkojë kompensim për ofrimin e shërbimit universal postar. Sipas pikës 1 të nenit 16, të Ligjit 46/2015, AKEP-i përcakton, me një rregullore, mënyrën e llogaritjes së koston neto, si dhe të përfitimeve të patrupëzuara, që duhen mbajtur parasysht në llogaritjen e kostove të sigurimit të shërbimit universal postar.

5. Dokumenti i përgatitur ka si objekt të krijojë kuadrin rregullator për përmbushjen e kërkesave ligjore të nenit 16 të Ligjit 46/2015, dhe ai përmban rregulla dhe udhëzime për ofruesit e shërbimit universal për llogaritje e kostove neto të shërbimit universal postar. Zbatimi i përcaktimeve të kësaj rregulloreje është i lidhur ngushtësisht me zbatimin e rregullores “*Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostove për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar*”. Në përgatitjen e dokumentit AKEP ka marrë në konsideratë përvojën në vendet e BE dhe rajonit, dhe dokumenta të ERGP për llogaritjen e kostove neto të shërbimit universal postar.
6. Dokumenti “*Rregullore për llogaritjen e kostove neto të Shërbimit Universal Postar*” është një dokument rregullator shumë i rëndësishëm në tregun e shërbimit postar dhe version përfundimtar i tij është përgatitur pas procesit të këshillimit publik me palët e interesuara dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor përkatës. Dokumenti ka marrë në konsideratë përvojën në vendet e BE dhe rajonit si dhe kushtet shqiptare në ofrimin e shërbimit postar.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar me lart, bazuar në pikën 1 të nenin 10, të ligjit 46/2015,

V E N D O S:

1. Të miratojë dokumentin “*Rregullore për llogaritjen e kostove neto të Shërbimit Universal Postar*”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ky Vendim dhe Dokumenti “*Rregullore për llogaritjen e kostove neto të Shërbimit Universal Postar*”, të publikohen në faqen e Internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Anila DENAJ
3. Ketrin TOPÇIU
4. Klarina AL LUSHI



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RREGULLORE

Nr. 42 DATË 3.03.2016

**PËR
LLOGARITJEN E KOSTOVE NETO TË
SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR**

(Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 2671, Datë 3.03.2016)

Permbajtja

1.HYRJE.....	3
2. RREGULLORJA DHE AUTORIZIMI INDIVIDUAL PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT UNIVERSAL.....	4
3. ELEMENTET E LLOGARITJES SË KOSTOS NETO	4
4. LLOGARITJA E KOSTOS NETO TË SHËRBIMIT UNIVERSAL	5
5. VLERËSIMI I BARRËS SË PADREJTË	13
6. FONDI I KOMPENSIMIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL	13
7. DETYRIMET E OFRUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL	14
8. PËRGJEGJËSITË E AKEP	15
9. ANEKS 1: Tabelat referuese për koston neto.....	17

1.HYRJE

Në bazë të nenit 31 të Ligjit 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, ofruesit e shërbimit universal postar duhet të mbajnë llogari të ndara, brenda sistemit të tyre të kontabilitetit, për të dalluar, në mënyrë të qartë, shërbimet dhe produktet që janë pjesë e shërbimit universal postar dhe ato që nuk janë pjesë e këtij shërbimi, me qëllim llogaritjen e kostove neto të shërbimit universal postar. Njëkohësisht në bazë të nenit 28, tarifat për çdo shërbim që bën pjesë në shërbimin universal postar duhet të jenë të orientuara drejt kostos dhe të sigurojnë nxitje për ofrimin efikas të shërbimit universal postar.

Në bazë të nenit 15 të Ligjit 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, kur ofrimi i shërbimit universal postar shkakton kosto neto shtesë, që mund të përbëjnë një ngarkesë të padrejtë për ofruesin e shërbimit universal postar, atëherë ofruesi i shërbimit universal postar ka të drejtë të kërkojë kompensim për ofrimin e shërbimit universal postar. Sipas pikës 4 të nenit 15, kostot neto për ofrimin e shërbimit universal postar llogariten si diferencë ndërmjet kostove neto për sigurimin e shërbimit universal postar dhe kostove që ofruesi i shërbimit universal postar do të kishte pasur nëse nuk do të ishte ofrues i shërbimit universal postar.

Sipas nenit 16, AKEP-i përcakton, me një rregullore, mënyrën e llogaritjes së kostos neto, si dhe të përfitimeve të patrupëzuara, që duhen mbajtur parasysh në llogaritjen e kostove të sigurimit të shërbimit universal postar. Neni 16 përcakton dhe procedurën që duhet të ndiqet në rast se ofruesi i shërbimit universal pretendon të drejtën e kompensimit për sigurimin e shërbimit universal postar. Sipas pikës 7 të nenit 16, AKEP, bazuar në llogaritjet për koston neto, përcakton nëse ofruesit të shërbimit universal postar i lind e drejta e kompensimit për shërbimet universale postare, si dhe përcakton nivelin e kompensimit mbi bazën e kostos neto. Në çdo rast, kompensimi kryhet vetëm pas miratimit nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore.

Neni 17 i ligjit 46/2015 përcakton mënyrën e krijimit të fondit të kompensimit të kostove neto të shërbimit universal, me fonde publike, i miratuar sipas legjislacionit në fuqi për ndihmën shtetërore dhe/ose me bashkëfinancim të ofruesve për shërbimin universal postar. Sipas pikës 3 të nenit 17, Rregullat për krijimin dhe administrimin e fondit për shërbimin universal postar, si dhe mënyra e përcaktimit të kontributit nga secili ofrues i shërbimit universal postar, në rastin e aplikimit të bashkëfinancimit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në bazë të nenit 31 të Ligjit 46/2015, ofruesit e shërbimit universal postar duhet të mbajnë llogari të ndara, brenda sistemit të tyre të kontabilitetit, për të dalluar, në mënyrë të qartë, shërbimet dhe produktet që janë pjesë e shërbimit universal postar dhe ato që nuk janë pjesë e këtij shërbimi, me qëllim llogaritjen e kostove neto të shërbimit universal postar.

AKEP me Vendimin nr.____, datë 3.03.2016 ka miratuar dokumentin “*Rregullore për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove për ofrimin e shërbimit universal postar*”, i cili përcakton rregullat dhe metodat për mbajtjen e llogarive të ndara, sistemin e kontabilitetit/llogaritjes së

kostos dhe procedurat e raportimit të ofruesit të shërbimit universal postar për zbatimin e këtyre detyrimeve.

Qëllimi i këtij dokumenti është të plotësojë kuadrin rregullator për llogaritjen e kostove neto të shërbimit universal postar, dhe procedurën për depozitimin dhe verifikimin e të dhenave për kostot neto.

2. RREGULLORJA DHE AUTORIZIMI INDIVIDUAL PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT UNIVERSAL

Në përgatitjen e skenarit komercial ofruesi i shërbimit universal duhet të bazohet te detyrimet e përcaktuara në Rreguloren e SHU të miratuar nga AKEP dhe Autorizimin Individual të lëshuar nga AKEP për ofruesin e Shërbimit Universal postar. Në bazë të kësaj rregulloreje, detyrimet për të marrë në konsideratë për llogaritjen së kostos neto mund të jenë si më poshtë:

1. Detyrimi për mbajtjen e një dendësie të caktuar të pikave të aksesit për pranimin e objekteve postare. Po të mos kishte detyrimin e mbajtjes së një rrjeti postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, ofruesi i shërbimit universal mund të zvogëlonte rrjetin e pikave të aksesit në zona të caktuara që dalin me humbje.
2. Detyrimi për mbajtjen e një frekuence të caktuar të dorëzimit të objekteve postare. Po të mos kishte detyrimin për dorëzimin e objekteve postare në baza ditore, nga e hëna deri të premten, ofruesi i shërbimit universal mund të zvogëlonte frekuencën e dorëzimit të objekteve postare.
3. Detyrimi i dorëzimit të objekteve postare në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Po të mos kishte detyrimin e dorëzimit të objekteve postare në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, ofruesi i shërbimit universal nuk do të kryente dorëzime të objekteve postare në zona të caktuara që janë me humbje.

Përveç pikave të lartpërmendura, rregullorja parashikon, ashtu si dhe ligji për shërbimin postar, që kostoja neto është çdo kosto e nevojshme dhe që lidhet me ofrimin e shërbimit universal, dhe llogaritet si një diferencë midis kostos neto me detyrimin e ofrimit të shërbimit universal dhe kostos neto pa detyrimin e ofrimit të shërbimit universal.

3. ELEMENTET E LLOGARITJES SË KOSTOS NETO

Me qëllim llogaritjen e kostos neto ofruesi i shërbimit postar që ka detyrimin e ofrimit të shërbimit universal duhet të llogarisë kostot/të ardhurat sipas kushteve të ofrimit të shërbimeve me detyrimin e shërbimit universal, si dhe një skenar reference (Komerical) pa detyrimin e shërbimit universal, duke marrë parasysh si vijon:

1. Kostoja neto bazohet vetëm në shpenzimet që lidhen me ofrimin e shërbimit universal, sipas një cilësie të përcaktuar;
2. Kur llogaritet kostoja neto marren parasysh vetëm elementet e mëposhtëm të shërbimeve universale :
 - a. ato që paraqesin një humbje për ofruesin e shërbimit universal, ose
 - b. ato që realizohen kur ofruesi i shërbimit universal vepron në kushtet e kostos të cilat nuk korrespondojnë me kushtet standarde të tregut;
3. Në llogaritjen e kostos neto merren gjithashtu në konsideratë: sigurimin e ofrimit të shërbimit universal për përdoruesit e veçantë ose grupet e përdoruesve që shkaktojnë një humbje për ofruesin e shërbimit universal, ose ato që janë kryer nën kushtet e kostos të cilat nuk korrespondojnë me termat standarde të tregut; Ky grup përfshin përdorues, apo grupe përdoruesish të cilët, ofruesi i shërbimit universal nuk do të mund ti kënaqte nëse do të vepronte në bazë të rregullave të zakonshme operative të tregut.
4. Kur ofrimi i shërbimit universal mund të sigurohet në cilësinë e përcaktuar në disa mënyra të ndryshme, kostoja neto llogaritet duke marrë parasysh mënyrën e ofrimit të shërbimit universal në cilësinë e përcaktuar me koston më të vogël, edhe nëse ofruesi i shërbimit universal zgjedh një mënyrë të ndryshme;
5. Kostos neto të shërbimit universal i zbriten të gjitha përfitimet materiale dhe jo-materiale (të patrupëzuara) që rezultojnë nga ofrimi i shërbimit universal; përfitimet materiale dhe jo-materiale të listuara si më poshtë:
 - Të ardhurat e shërbimit universal, si dhe të ardhurat nga shërbimet e tjera të ndryshme nga ato universale, të cilat ofruesi i shërbimit universal nuk do t'i kishte realizuar nëse nuk do të kishte qenë ofruesi i shërbimit universal,
 - Vlera e rritur e markës për shkak të ofrimit të shërbimit universal,
 - Reduktimi i kostos së ofrimit të shërbimeve të tjera për shkak të efekteve të bashkëveprimit të ofrimit të shërbimit universal,
 - Përfitime të tjera materiale dhe jo-materiale të përcaktuara nga AKEP;
6. Ofruesit të shërbimit universal i jepet e drejta për të përfituar në mënyrë të përshtatshme nga ofrimi i shërbimeve universale, në një mënyrë që siguron një nivel të efektivitetit të kostos, të cilën ai do ta kishte përfituar nëse nuk do të kishte pasur detyrimin e ofrimit të shërbimit universal.

4. LLOGARITJA E KOSTOS NETO TË SHËRBIMIT UNIVERSAL

1. Llogaritja e kostos neto të shërbimit universal përfshin:

a) Llogaritjen e kostos neto të ofrimit të shërbimit universal në përputhje me kushtin e ofrimit me kosto efektive të SHU, më konkretisht kostot direkte dhe pjesa të kostove indirekte në lidhje me ofrimin e shërbimit universal. Këto kosto të shërbimit universal janë kostot që që çdo ofrues i caktuar i shërbimit universal do të zgjidhte të shmangte, nëse nuk do të kishte detyrimin e ofrimit të shërbimit universal (në vijim "Skenari Komercial").

b) Llogaritja e përfitimeve përfshin përfitimet materiale dhe jo-materiale që ofruesi i SHU gjeneron nga ofrimi i shërbimit universal.

2. Për qëllimet e llogaritjes së kostos neto të shërbimit universal, ofruesi i shërbimit universal zhvillon një Skenar Komercial i cili modelon mënyren e ofrimit të shërbimit, nëse ky ofrues nuk do të kishte detyrimin e shërbimit universal. Skenari Tregtar kryesisht fokusohet në:

a) ndryshimet në dendësinë e pikave të aksesit për pranimin e objekteve postare;

b) ndryshimet në frekuencën e dorëzimit të objekteve postare;

c) ndryshimet në mbulimin gjeografik të rrjetit të shpërndarjes;

d) shërbimet pa pagesë të ofruara për të verbërit;

e) shërbime dhe ndryshime të tjera lidhur me ofrimin e shërbimit, të cilat nuk do të ofroheshin ose do të ofroheshin në kushte të ndryshme nëse nuk do të ekzistonte detyrimi i shërbimit universal.

3. Skenari Tregtar duhet të jetë real dhe konkurrues, duke konfirmuar përpjekjet e ofruesit të shërbimit universal për të ruajtur pozicionin e tij në treg dhe në hartimin e tij duhet të merren parasysh të paktën faktorët mëposhtëm:

a) kushtet gjeografike dhe dendësia e popullsisë;

b) frekuenca e dorëzimit;

c) produktet dhe shërbimet e ofruara;

d) cilësinë e kërkuar të shërbimit;

e) dendësinë e kërkuar të rrjetit postar;

f) elasticitetin e kërkesës.

4. Kostot neto të shërbimit universal llogariten si diferencë ndërmjet pozicionit ekonomik të ofruesit të shërbimit universal postar me detyrim të shërbimit universal dhe pa këtë detyrim (Skenari Komercial), sipas formulës së mëposhtme:

$$NCUS = \Sigma \Delta CNCi + \Sigma \Delta DNCi + STC + OHC + FSR - MB + fitimi + të tjera$$

Ku:

NCUS - Kostot neto të shërbimit universal;

CNCi – kursimet (kostot e shmangura) për shkak të ndryshimeve të dendësisë së pikave të aksesit;

DNCi - kursimet për shkak të ndryshimeve në aktivitetet e shpërndarjes;

STC - shpenzimet e transportit dhe përpunimit të lidhur me detyrimin e shërbimit universal që do të shmangeshin nëse operohet nën skenarin tregtar;

OHC – kursimet nga ndryshimi në kostot operative, nëse operohet nën skenarin Komercial;

FSR - të ardhurat e mundshme që do të merreshin nga ofrimi i shërbimeve universale falas në bazë të Nenit 28, pika 4 e Ligjit 46/2015;

MB - vlera totale e përfitimeve të tregut nga ofrimi i shërbimit universal;

Fitimi - Niveli i arsyeshëm i fitimit;

Të tjera - shërbime të tjera dhe ndryshime në aspektin e ofrimit të cilat nuk do të ofroheshin ose do të ofroheshin me kushte të ndryshme nëse nuk do të ekzistonte detyrimi i shërbimit universal.

a) i) Ndryshimi në fitim ose humbje nga aktivitetet e pranimit (CNCi) është shuma e ndryshimeve në të ardhura dhe shpenzimeve për secilën zyrë postare që do rezultonte nga zhvendosja e aktiviteteteve të grumbullimit nga zyrat postare jo-fitimprurëse (me humbje) në zyrat e tjera postare për shkak të përdorimit së skenarit Komercial. Një zyrë postare konsiderohet jo-fitimprurëse (me humbje) nëse:

Ccpi > Rcpi

Ku:

Ccpi - kostot e shërbimeve të ofruara nga një zyrë postare individuale

Rcpi - të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve që janë pjesë e detyrimit të SHU dhe shërbimeve që nuk janë pjesë e detyrimit të SHU të një zyre postare individuale

ii) Kursimet për shkak të ndryshimeve në dendësinë e pikave të aksesit llogariten në bazë të formulës:

$$\Delta CNCi = \Sigma (Cci - Rci) - \Sigma (Csi - Rsi)$$

Ku:

Cci - Kostot e shërbimeve të ofruara nga një zyrë postare individuale me humbje;

Rci - Të ardhurat që merren nga shërbimet që janë pjesë e detyrimit të SHU dhe shërbimeve që nuk janë pjesë e detyrimit të SHU të një zyre postare individuale me humbje, të cilat do të humbisnin për shkak të mbylljes së zyrës postare

Csi – Kostot shtesë të zyrave të tjera postare për shkak të zhvendosjes së vëllimit të shërbimit postar nga zyrat postare me humbje në këto zyra;

Rsi – të ardhurat shtesë të zyrave të tjera postare për shkak të zhvendosjes së vëllimit të shërbimeve postare nga zyrat postare me humbje në këto zyra;

Inputet përkatëse të të dhënave janë paraqitur në Aneksë - Tabela 2: Kostot, Të ardhurat dhe Fitimet/Humbjet nga aktivitetet e pranimit të zyrave postare individuale, dhe Tabela 3: Kursimet për shkak të ndryshimeve në dendësinë e pikave të aksesit.

b) i) Kursimi për shkak të ndryshimeve në aktivitetet e shpërndarjes është shuma e ndryshimeve në kosto për çdo zonë shpërndarje që rezultojnë nga ndryshimet në mënyrën shpërndarjes në zonat jofitimprurëse dhe rënies së të ardhurave, si pasojë e ndryshimeve në ofrimin e disa shërbimeve që nuk do të ofroheshin në zona jofitimprurëse.

ii) Kursimet për shkak të ndryshimeve në aktivitetet e shpërndarjes llogariten sipas formulës:

$$\Sigma \Delta DNCi = \Sigma \Delta (PDCi + ODCi - RDi)$$

Ku:

PDCi - Shpenzimet e personelit të postës për zonën ku ofruesi i shërbimit universal do të kursente për shkak të rritjes së kohës së dorëzimit me një frekuencë të reduktuar të shpërndarjes;

ODCi - shpenzime të tjera që lidhen me kursimin e kohës së dorëzimit (p.sh. zyrat postare të shpërndarjes, kursimet e karburantit për dorëzimin me mjete motorike, taksat e përdorimit të autostradës, pagesat e shërbimeve, tarifatat e transportit hekurudhor, tarifatat e transportit ajror, shpenzimet e konsumit);

RDi - të ardhurat për produktin që ofruesi i shërbimit universal nuk do të merrte në qoftë se nuk do të kishte siguruar shpërndarjen e përditshme në nivelin e caktuar të cilësisë sipas detyrimit të SHU;

Inputet e të dhënave përkatëse janë paraqitur në Aneksë - Tabela 4: Kursimet për shkak të ndryshimeve në aktivitetet e shpërndarjes.

c) **STC** - janë shpenzimet e transportit dhe përpunimit të lidhura me shërbimin universal që ofruesi i shërbimit nuk do të kryente si rezultat i ndryshimeve në rrjetin e zyrave postare dhe mënyrën e shpërndarjes, nëse do të operonet sipas Skenarit Komercial.

d) **OHC** - janë shpenzimet e përgjithshme administrative të cilat do të kurseheshin nga ofruesi i shërbimit universal për shkak të ndryshimeve sipas Skenarit Komercial.

e) **FSR** - janë të ardhurat e mundshme të humbura nga ofruesi i shërbimit universal në skenarin e ofrimit të shërbimit universal në përputhje me pikën 4 të nenit 28 të Ligjit 46/2015, pasi këto

shërbime ofrohen falas. Në mungesë të detyrimit këto shërbime do të ofroheshin sipas kushteve standarde të tregut.

Të ardhurat e mundshme nga shërbimet e ofruara falas llogariten sipas formulës së mëposhtme:

$$\mathbf{FSR = V_0 \times P_b}$$

Ku:

V₀ - vëllimi i shërbimeve të ofruara pa pagesë sipas pikës 4 të nenit 28 të Ligjit 46/2015;

P_b - çmimi standard për shërbimet e krahasueshme me shërbimet e ofruara falas në kuadër të detyrimit të shërbimit universal.

Inputet përkatëse të të dhënave janë paraqitur në Anekse - Tabela 5: Të ardhurat e mundshme nga shërbimet e ofruara falas.

f) i) Përfitimet e tregut janë ato përfitime për ofruesin e shërbimit universal që rrjedhin nga ofrimi i shërbimit universal dhe që nuk do të ishin gjeneruar, në mungesë të detyrimit të ofrimit të shërbimit universal. Përfitimet e tregut nga ofrimi i shërbimit universal vlerësohen financiarisht si përfitime materiale dhe jo-materiale (të patrupëzuara) të tregut që rezultojnë nga ofrimi i shërbimit universal.

Vlera e përfitimeve materiale të tregut është drejtpërdrejt e përfshirë në kostot neto të formulës së llogaritjes së shërbimit universal, ku merren parasysh ndryshimet në shpenzime dhe në të ardhura. Ky seksion përcakton më tej përfitimet jo-materiale (të patrupëzuara) të tregut:

ii) Përfitimet jo-materiale (të patrupëzuara) të tregut janë:

1) Përfitimi tatimor, si përjashtimi nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), pasi shërbimet brenda fushës së detyrimit të shërbimit universal janë të përjashtuara nga detyrimi i TVSH-së.

Formula e llogaritjes:

$$\mathbf{TB = (Rev\ 0 - Rev1) - (Kosto\ 0 - Kosto\ 1)}$$

Ku:

TB – vlera e përfitimit tatimor;

Rev 0 - të ardhurat e ofruesit të shërbimeve universale nga ofrimi i shërbimit universal;

Rev 1 - të ardhurat e ofruesit të shërbimeve universale nga ofrimi i shërbimit universal sipas Skenarit Komercial. Të ardhurat sipas këtij skenari parashikohen të reduktohen për shkak të rregullimit të çmimeve neto të shërbimit universal, si rezultat i shtimit të TVSH-së;

Kosto 0 - kostoja e shërbimeve të përjashtuara nga TVSH në skenarin bazë të operimit me detyrim të shërbimit universal;

Kosto 1- kostoja e shërbimeve të përjashtuara nga TVSH në skenarin komercial (pa përjashtim të TVSH);

Për skenarin komercial të supozohet rritje e cmimit me 20% dhe elasticiteti i kërkesës ndaj cmimit i barabartë me -0.5.

2) Rritja e reputacionit të korporatës dhe vlerës së markës për shkak të statusit të ofruesit të shërbimit universal, pasi konsumatorët caktojnë një vlerë të shtuar për markën e ofruesit si rezultat i ofrimit të shërbimeve universale në një cilësi dhe nivel besueshmërie të caktuar.

Formula e llogaritjes:

$$EB = MC \times SC$$

Ku:

EB - Reputacioni i rritur i korporatës dhe vlera e përfitimit të markës

MC - Shpenzimet e marketingut të ofruesit të shërbimit universal

SC – Proporcioni i shpenzimeve të marketingut që do të kryheshin nga ofruesi i shërbimit universal sipas Skenarit Komercial për të rritur vlerën e markës së tij

SC nuk ka të ngjarë të tejkalojë **20%** të shpenzimeve vjetore të marketingut të ofruesit të shërbimit universal.

3) Rritja e efektit të publicitetit që vjen ng numri më i madh i ndërtesave të zyrave postare, kutive postare, automjeteve postare dhe postierëve, të cilët mund të bartin logon e ofruesit të shërbimit universal, apo mund t'u jepet me qira palëve të treta.

Formula e llogaritjes:

$$AE = (TAS/AF) \times RPP + (VAS0 \times RPV - VAS1 \times RPV) + NM \times RPM$$

Ku:

AE - rritjes e vlerës së përfitimit nga publiciteti

TAS – ulja e hapësirës për publicitet në sipërfaqe dhe në brendësi të ndërtesave në Skenarin Komercial

AF – parametra te publicitetit (mesatarja e sipërfaqes/hapësirës së publiciteit)

RPP - çmimi referencë për madhësinë e përcaktuar të hapësirës publicitare

VAS0 - numri i automjeteve në skenarin e ofrimit të shërbimit universal

VAS1 - numri i automjeteve në skenarin komercial

RPV - çmimi referencë për reklamat në automjete në një frekuencë të caktuar shfaqjeje

NM - ndryshimi në numrin e postierëve në skenarin e ofrimit të shërbimit universal dhe skenarin komercial

RPM - çmimi referencë për reklamat e vendosur në uniforma

Vlera e çmimeve të referencës duhet të reflektojë pagesat e marra nga ofruesi i shërbimit universal në rast të përdorimit komercial të hapësirës së tij të reklamave/publicitetit.

4) akses i privilegjuar në tregun e filatelistë, pasi ofruesi i shërbimit universal është Subjekti që ka të drejtën ekskluzive të emetimit dhe prodhimit të pullave postare.

Formula e llogaritjes:

$$PM = TRS - USV$$

Ku:

PM – akses i privilegjuar në vlerën e përfitimit në tregun e filatelistë

TRS - të ardhurat totale nga pullat

USV - vlera e pullave të përdorura

5) Fitimet dhe kostot e interesave nga dhënia e periudhave shtesë të pagesës.

Fitimet nga interesat për shkak të parapagimeve të shpenzimeve postare, pasi pullat postare janë parapagime të shërbimeve të ofruesit të shërbimit universal, të cilat i japin atij përfitimin e kredisë pa interes.

Kostot nga interesat lindin në rastin kur ofruesi i shërbimit universal mundëson periudha shtesë pagese për shpërndarësit pullave, kur ofruesi i shërbimit universal u ofron shërbim konsumatorëve para se të marrë pagesën aktuale nga shpërndarësi.

Të dy efektet e përshkuara më sipër kanë efekte kompensuese me njëri-tjetrin.

Formula e llogaritjes:

$$IP = SR \times SOH \times CC - LI \times CC$$

Ku:

IP – vlera e fitimeve të interesit;

SR - të ardhurat vjetore të ofruesit të shërbimeve universale nga pullat e shitura për qëllime jo-filatelite;

SOH - pjesa e pullave postare (përqindja mesatare) në shitjen vjetore që mbetet tek blerësit për përdorim në një periudhë të ardhshme;

CC - shpenzimet kapitale të ofruesit të shërbimit universal;

LI - të ardhurat e gjeneruara nga shitja e pullave për shpërndarësit me shtyrje pagese;

6) Përrjashtimi nga licenca e transportit, taksat mbi automjetet apo të ngjashme. Ofruesi i shërbimit universal mund të jete i përjashtuar nga disa detyrime, të tilla si pagesat e tarifave të parkimit, ose pagesat e taksave të automjeteve.

Formula e llogaritjes:

$$\mathbf{FE = NV \times F}$$

Ku:

FE - Vlera e përfitimit nga përjashtimi nga taksat

NV - numri i automjeteve

F - tarifë standarde, e cila mund të përfaqësohet nga tarifa e parkingut ose tarifa të tjera, niveli i taksës për automjetin, ose tarifa të tjera të aplikueshme.

Vlerat e përfitimeve të veçanta të Patrupëzuara janë përmbledhur në Aneks - Tabela 6: Përfitimet e patrupëzuara të tregut.

g) Fitim do të thotë një nivel i arsyeshëm fitimi, i cila shprehet si kthimi nga kapitali i përdorur për shërbimit universal (**jo më shumë se 10%**), ose si një marzh fitimi që lidhet me shpenzimet neto/të ardhurat të shërbimit universal (**jo më shumë se 20% e të ardhurave nga shërbimi universal**).

h) Ndryshime të tjera në fitimet ose humbjet e ofruesit të shërbimit universal, të cilat do të gjeneroheshin me skenarin komercial dhe do të ishin të ndryshme nga detyrimet e përcaktuara brenda objektit të shërbimit universal. Këto janë kryesisht shërbime dhe ndryshime të tjera në aspektin e ofrimit shërbimit universal të cilat nuk do të ofroheshin ose do të ofroheshin në kushte të ndryshme nëse detyrimi i shërbimit universal nuk do të ekzistonte.

i) Përfitimet nga zona e rezervuar

Ofruesi aktual i shërbimit universal (Posta Shqiptare) përfiton nga zona e rezervuar e cila do të jetë në fuqi deri më 31.12.2016. Posta Shqiptare duhet të llogarisë përfitimet neto nga zona e rezervuar, d.m.th të ardhurat shtesë si diferenca e të ardhurave me prezence të zonës së rezervuar dhe në mungesë të saj.

5. VLERËSIMI I BARRËS SË PADREJTË

1. Për të ndërmarrë dhe për të krijuar një mekanizëm kompensimi për rimbursimin e kostove neto të shërbimit universal, sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje, kostot neto të shërbimit universal duhet të përfaqësojnë një barrë të padrejtë të vendosur mbi ofruesin e shërbimit universal.

2. Shpenzimet neto të shërbimit universal përfaqësojnë një barrë të padrejtë të vendosur mbi ofruesin universal të shërbimit në qoftë se shumica e kostove neto të shërbimit universal arrin një vlerë, e cila nuk mund të jetë, duke vlerësuar gjendjen ekonomike të ofruesit, e përballueshme nga ofruesi i shërbimit universal.

3. Për të vendosur se kur kostot neto të shërbimit universal përfaqësojnë një barrë të padrejtë, AKEP vlerëson:

- a) nëse kostot neto të shërbimeve universale përbëhen vetëm nga kostot e vërtetueshme dhe ekonomikisht të pranueshme,
- b) nëse vlera e kostos neto të shërbimit universal e llogaritur në bazë të parimeve të përcaktuara në këtë rregullore është pozitive,
- c) nëse vlera e kostos neto të shërbimit universal e llogaritur në bazë të parimeve të përcaktuara në këtë rregullore tejkalon kostot e mundshme operative të mekanizmit të kompensimit,
- d) nëse kostot neto të kuantifikuara të shërbimit universal në pajtim me nenin 4 të kësaj rregulloreje tejkalojnë 1% të kostos totale të ofruesit të shërbimit universal,
- e) nëse marzhi EBITDA i ofruesit të shërbimeve universale është më shumë se 5 pikë përqindje më e ulët se mesatarja EBITDA e 3 ofruesve më të mëdhenj të shërbimeve postare të pranishëm në treg. Llogaritja bazohet në informacione të vërtetueshme dhe ekonomikisht të pranueshme nga evidenca kontabël e ofruesit të shërbimit universal dhe konkurrentëve të tij.
- f) nëse kostot neto të shërbimit universal përbëjnë pjesë të konsiderueshme të fitimit të ofruesit të shërbimeve universale para tatimit.
- g) nëse ofruesi i shërbimit universal që del krejtësisht me humbje, do të kishte fitim në qoftë se kostot neto të shërbimit universal do të komensoheshin.

4. Shpenzimet neto të shërbimit universal do të konsiderohen se përfaqësojnë një barrë të padrejtë në qoftë se përmbushen të paktën 4 nga kriteret e seksionit mësipërm të këtij neni.

6. FONDI I KOMPENSIMIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL

Fondi i kompensimit të shërbimit universal postar krijohet me fonde publike, i miratuar sipas legjislacionit në fuqi për ndihmën shtetërore dhe/ose me bashkëfinancim të ofruesve të shërbimit postar. Rregullat për krijimin dhe administrimin e fondit për shërbimin universal postar, si dhe mënyra e përcaktimit të kontributit nga secili ofrues i shërbimit universal postar, në rastin e aplikimit të bashkëfinancimit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas përcaktimeve të nenit 17 të Ligjit 46/2015, dhe akteve të tjera nënligjore.

7. DETYRIMET E OFRUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL

1. Ofruesi i shërbimit universal postar, i cili pretendon të drejtën e kompensimit për sigurimin e shërbimit universal postar, duhet të paraqesë në AKEP pretendimin, së bashku me informacionin për kostot reale, të dhënat e përdorura për llogaritjen e kostove neto aktuale të shërbimit universal postar dhe pasqyrat financiare. Kjo kërkesë së bashku me të gjithë informacionin për kostot neto, duhet të depozitohet në AKEP jo më vonë se data 30 Qershor për vitin e mëparshëm.
2. Së bashku me kërkesën për kompensim të barrës së padrejtë, ofruesi i shërbimit universal duhet t'i dorëzojë AKEP-it një raport të auditimit, si dhe llogaritjen e kostos reale neto, të përpiluar në përputhje me nenet 15 dhe 16 të ligjit 46/2015 si dhe me përcaktimet e kësaj rregulloreje. Përveç kësaj, ofruesi i shërbimit universal është i detyruar, që me kërkesën e AKEP, të japë shpjegime shtesë të kostos neto.
3. Për qëllime të llogaritjes së kostos neto të shërbimit universal, ofruesi i shërbimit universal duhet:
 - a) Të mbajë llogaritë e ndara dhe llogarisë koston e shërbimeve sipas përcaktimeve të rregullores përkatëse të miratuar nga AKEP për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e koston.
 - b) të llogarisë kostot neto të shërbimit universal në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë rregullore,
 - c) të llogarisë vlerën e përfitimeve të tregut që rezultojnë nga ofrimi i shërbimit universal sipas parimeve të përcaktuara në këtë rregullore,
 - d) të depozitojë pranë AKEP të dhënat e llogaritjeve në formën dhe masën e përcaktuar në anekset - Tabela 1 deri në 6 të kësaj rregulloreje,
 - e) të vendosë në dispozicion të AKEP të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për qëllime të vlerësimit të provave për kostot e shkaktuara.
4. Në procesin e llogaritjes së kostos neto, ofruesi i shërbimit universal duhet t'i përmbahet parimeve të mëposhtme:
 - a) kostot lidhur me ofrimin e shërbimit universal në cilësinë e caktuar,
 - b) llogaritja e kostos merr në konsideratë kostot e ofrimit të shërbimeve për grupe të veçanta të përdoruesve, në të cilat ofruesi i shërbimeve të tilla pëson humbje, ose të cilat janë kryer nën kushte të tilla dhe me kosto që nuk përputhen me kushtet normale të tregut dhe nuk do të ishin ofruar pa detyrimin e shërbimit universal,
 - c) për llogaritjen e kostove neto ndjek parimin e transparencës dhe të gjithë elementet e koston duhet të jenë të gjurmueshëm me të dhënat burimore themelore dhe duhet të jenë të vërtetuara me dokumentacionin e duhur,

- d) pjesët e kostove neto të llogaritura veçmas duhet të përmbliidhen në mënyrë që të shmanget llogaritja e dyfishtë,
- e) gjatë ofrimit të shërbimit universal, ofruesi ka të drejtë të realizojë një fitim të arsyeshëm, i cili duhet të përputhet me nivelin e fitimit që do të arrihej pa detyrimin e ofrimit të shërbimit universal,
- f) kostoja neto e shërbimit universal duhet të zbritet nga përfitimet e mundshme tregtare të ofruesit të shërbimit universal që burojnë nga ofrimi i shërbimit universal.

8. PËRGJEGJËSITË E AKEP

1. Në përputhje me ligjin 46/2015, AKEP kryen kontrollin dhe verifikimin e informacionit të paraqitur për kostot neto të SHU me ekspertë kontabël të pavarur. **AKEP** vlerëson dhe verifikon:
 - a. nëse kostot neto të shërbimit universal përbëhen vetëm nga kosto të vërtetueshme dhe ekonomikisht të pranueshme, kosto konkrete direkte dhe indirekte, që çdo ofrues i caktuar i shërbimit universal do të kishte zgjedhur të shmangte, nëse nuk do të kishte pasur asnjë detyrim të shërbimit universal,
 - b. pajtueshmërinë e parimeve të përdorura nga ofruesi i shërbimit universal në procesin e llogaritjes së kostos neto, me parimet përkatëse të përcaktuara në këtë rregullore,
 - c. ekzistencën e barrës së padrejtë financiare, në përputhje me parimet përkatëse të përcaktuara në Kapitullin 5, pika 3 të kësaj rregulloreje,
 - d. shumën e kostos neto që përbën barrë të padrejtë financiare, dhe merr masa/vendime të nevosjhme në lidhje me kompensimin e kostove neto të shërbimit universal sipas parimeve përkatëse të përcaktuara në këtë rregullore dhe në përputhje me ligjin 46/2015 dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave për krijimin dhe administrimin e fondit të kompensimit të SHU.
2. AKEP në përfundim të verifikimit AKEP:
 - a. konfirmon llogaritjen e kostove reale (neto) për sigurimin e shërbimit universal postar; ose
 - b. kërkon kryerjen e korrigjimeve përkatëse, nëse vëren se llogaritjet nuk janë të sakta.
3. AKEP merr një vendim në lidhje me vlerësimin e kostos neto të barrës së padrejtë zakonisht brenda 60 ditëve, por jo më vonë se gjashtë muaj nga paraqitja e kërkesës së plotë të ofruesit të shërbimit universal.
4. AKEP-i, në vlerësim, merr parasysh edhe kostot e sigurimit të shërbimit universal postar, të paraqitura nga ofruesi në procesin e përzgjedhjes, sipas pikës 4, të nenit 13 të ligjit 46/2015, kur kjo është e aplikueshme.
5. AKEP-i vlerëson diferencat në kosto vetëm në rastet kur kushtet kanë ndryshuar, nga koha e dhënies së autorizimit të ofruesit të shërbimit universal postar, dhe provon, në mënyrë bindëse, objektive dhe transparente këto diferenca. AKEP-i publikon rezultatet e llogaritjes së kostove dhe të ekspertizës së kryer për informacionin e paraqitur nga ofruesi i shërbimit universal postar.

6. AKEP-i, bazuar në llogaritjet, përcakton nëse ofruesit të shërbimit universal postar i lind e drejta e kompensimit për shërbimet universale postare, si dhe përcakton nivelin e kompensimit mbi bazën e kostos neto. Në çdo rast, kompensimi kryhet vetëm pas miratimit nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore.

9. ANEKS 1: Tabelat referuese për koston neto

Tabela 1: Përmbledhje e Rezultateve

	Shkurtim	Vlera në LEK
Ndryshimet në kosto dhe të ardhura		
Ndryshimet në fitime ose humbje nga aktiviteti i pranimit	Σ Δ CNCi	
Ndryshimet në aktivitetet e shpërndarjes	Σ Δ DNCi	
Ndryshimet në kostot e transportit dhe përpunimit	STC	
Kostot e Përgjithshme administrative	OHC	
Të ardhura të humbura nga shërbimet pa pagesë	FSR	
Përfitimet e Tregut	MB	
Përrjashtimi nga TVSH	TB	
Rritje e reputacionit dhe vlerës së markës	EB	
Efekti i rritur i publicitetit	AE	
Akses eskuziv në filateli	PM	
Të ardhura nga interesa e postës së parapaguar	IP	
Përrjashtime nga licenca transporti, tarifë parkimi, taksë automjeti etj.	FE	
Përfitime nga zona e rezervuar	ZR	
Fitim i arsyeshëm	Fitim	
Ndryshime të tjera në Skenarin Komercial	Të tjera	
Total		

Tabela 2: Kostot, Të ardhurat dhe Fitimi/Humbja nga aktivitetet e pranimit sipas zyrave individuale postare

Zyrat postare në Skenarin Komercial		Ccpi	Rcpi	Rcpi <>Ccpi
Kodi postar	Zyra Postare (i)	Kostot e shërbimeve të zyrës postare individuale (i)	Të ardhurat nga shërbimet të zyrës postare individuale (i)	Fitimi/humbja e zyrës postare individuale (i)
	Zyra Postare 1			
	Zyra Postare 2			
	Zyra Postare n			

Tabela 3: Kursimet për shkak të ndryshimeve në dendësinë e pikave të aksesit

		Rci	Cci	Rsi	Csi	$\Delta CNCi = \Sigma (Cci - Rci) - \Sigma (Csi - Rsi)$
Kodi postar	Zyra Postare (i)	Të ardhurat e zyrave postare me humbje	Kostot direkte të zyrave postare me humbje	Të ardhurat e zhvendosura në zyra të tjera postare	Kostot e zhvendosura në zyra të tjera postare	Kursimet për shkak të ndryshimeve në dendësinë e pikave të aksesit
	Zyra Postare 1					
	Zyra Postare 2					
	Zyra Postare n					
Total		Σ	Σ	Σ	Σ	Σ

Tabela 4: Kursimet për shkak të ndryshimeve në aktivitetet e shpërndarjes

		Skenari me Sherbim Universal									Skenari Komericial				
Zona	Rajoni	Frekuenca e shpërndarjes sipas detyrimit të SHU	km te udheatuara			Numri i personave			Zona	Frekuenca e shpërndarjes sipas Skenarit komercial	PDCi	ODCi	Rdi	$\Sigma \Delta DNCi = \Sigma \Delta (PDCi + ODCi - RDi)$	
			në këmbë	Moto-ciklete	Biciklete	Makine	në këmbë	Moto-ciklete							Biciklete
Total	x	x				x	x	x		x	Σ	Σ	Σ	Σ	

Tabela 5: Të ardhurat oportune (të mundshme) nga shërbimet e ofruara pa pagesë

	Vo	Pb	FSR = Vo x Pb
Shërbimi (i)	Volumi i shërbimeve të ofruara pa pagesë	Tarifat standarde të shërbimeve të krahasueshme me ato të ofruara pa pagesë	Të ardhurat e mundshme nga ofrimi i shërbimeve pa pagesë
Shërbimi 1			
Shërbimi 2			
Shërbimi 3			
Shërbimi 4			
Shërbimi 5			
Total	x	x	Σ

Tabela 6: Përfitimet e patrupëzuara të tregut

Përfitimi	Përrjashtimi nga tatimet	Vlera e rritur e reputacionit dhe markës	Efekti i rritur i publicitetit	Aksesi eskluziv ne filateli	Fitimi nga interesat e postës së parapaguar	Përrjashtime nga licensa transporti, taksa autommjeti ose te ngjshme	Përfitme nga zona e rezervuar	Total
Vlera								Σ